

VENDIM
Nr. 122, datë 8.8.2017

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S ME NR. 75, DATË 26.5.2017, “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 25, DATË 15.2.2017, “MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 169, DATË 31.10.2016, “MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE-S NR. 103, DATË 23.6.2016, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, germa “I” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.8.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr. 75, datë 26.5.2017, “Mbi miratimin e një ndryshimi në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 169, datë 31.10.2016, “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

1. Mbështetur në nenin 19, germa “I”, ERE miraton, me propozim të të licencuarve, rregullat për: i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

2. OSHEE sh.a., gjithashtu në shkresën me nr. 19110 Prot., datë 4.8.2017 ka kërkuar shtyrjen e vendimit të bordit të ERE-s me nr. 75, datë 26.5.2017, me 60 ditë.

3. OSHEE sh.a. bën me dije se grupi i punës i ngritur nga OSHEE sh.a. ka filluar punën me qëllim krijimin e platformës *online* për prokurim/blerjen *online* të energjisë elektrike dhe është hapur procedura me objekt “ndërtimi i platformës elektronike të publikimit të të dhënave të blerësit dhe shitësit në funksion të blerjes/shitjes së energjisë elektrike”.

4. OSHEE sqaron se, duke marrë parasysh afatet ligjore që parashikon ligji i prokurimit publik “... autoriteti kontraktor fton operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën jo më vonë se 60 ditë nga data e publikimit”, *si dhe të depozitojë dokumentet standarde të tenderit, ku kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor i ekzekutimit është 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.*

5. ERE ka nisur më herët procedurat për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, dhe është ende në fazën e shqyrtimit të tyre.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 1 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 75, datë 26.5.2017, si më poshtë:

Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e

shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 103, datë 23.6.2016, hyn në fuqi brenda datës 30.9.2017.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
Agim Nashi